



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.62

31 maj

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.101, datë 17.5.2007	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore	1691
Vendim i Kuvendit nr.102, datë 21.5.2007	Për zgjedhjen e Avokatit të Prokurimeve	1692
Dekret nr.5316 datë 18.5.2007	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	1692
Dekret nr.5324 datë 21.5.2007	Për emërim ambasadori	1693
Dekret nr.5330 datë 23.5.2007	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	1693
Akt normativ nr.1, datë 25.5.2007	Për lejimin e hyrjes, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të disa njësive të forcave ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në kuadër të operacionit të masave të sigurisë, për vizitën e Presidentit Amerikan në Shqipëri	1694
Vendim i KM nr.289, datë 22.5.2007	Për lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	1695
Vendim i KM nr.294, datë 16.5.2007	Për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, dërguar me misione ushtarake jashtë shtetit.....	1696
Vendim i KM nr.296, datë 16.5.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i rrethrotullimit dhe unazës lindore, Fier.....	1696

Vendim i KM nr.297, datë 16.5.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken si rezultat i rehabilitimit të shkarjeve të ndodhura në segmentin rrugor Zona IV, Prosek.....	1701
Urdhër i BSH nr.4/1, datë 24.5.2007	Për miratimin e shtesës së një veprimtarie financiare në licencën e subjektit financiar jobankë “Credins” sh.a.....	1704
Vendim i ERE nr.31, datë 19.5.2007	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga H/C Egnatia, komuna Hotolisht, Librazhd, të “Remi” sh.p.k.....	1704
	Ndreqje gabimi.....	1706

VENDIM
Nr.101, datë 17.5.2007

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN
ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

II. Komisioni ka për detyrë përgatitjen e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor, për arritjen e standardeve në zgjedhjet politike dhe administrative.

III. Komisioni përbëhet nga 18 anëtarë, 9 nga shumica dhe 9 nga opozita parlamentare. Anëtarët që i përkasin shumicës parlamentare caktohen: 2 nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, 2 nga Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, 2 nga Grupi Parlamentar Demokristian, 1 nga Grupi Parlamentar “Demokrat-Reformator”, 1 nga Grupi Parlamentar i Partisë Agrare Ambientaliste, 1 nga Grupi Parlamentar “Qendra Demokrate”. Anëtarët që i përkasin opozitës caktohen: 3 nga Partia Socialiste, 2 nga Partia Social-Demokrate, 2 nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, 1 nga Partia Aleanca Demokratike, 1 nga Partia Demokracia Sociale.

IV. Komisioni i Posaçëm Parlamentar drejtohet nga dy bashkëkryetarë: një nga Partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste.

V. Pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

VI. Vendimet në komision merren me shumicën e votave (10 vota), kur pro tyre kanë votuar në unanimitet përfaqësuesit e dy partive të mëdha.

VII. Komisioni ushtron veprimtarinë për një periudhë prej 3 muajsh nga data e vendimit.

VIII. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së komisionit.

IX. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

1. Ilir Rusmali (Bashkëkryetar)	-	PD
2. Arjan Starova	-	PD
3. Arjan Madhi	-	PR
4. Artur Hasanbelliu	-	PR
5. Ndue Shpani	-	PDK
6. Pashko Ujka	-	PDK
7. Tritan Shehu	-	PDR
8. Petrit Gjoni	-	PAA
9. Spiro Peçi	-	PBDNJ
10. Kastriot Islami (Bashkëkryetar)	-	PS
11. Fatmir Xhafa	-	PS
12. Alfred Dalipi	-	PS
13. Engjëll Bejtaj	-	PSD
14. Skënder Gjinushi	-	PSD
15. Sabit Brokaj	-	LSI
16. Ndre Legisi	-	LSI
17. Neritan Ceka	-	PAD
18. Paskal Milo	-	PDS

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.102, datë 21.5.2007

PËR ZGJEDHJEN E AVOKATIT TË PROKURIMEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 76 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Edi Spaho zgjidhet në detyrën e Avokatit të Prokurimeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.5316, datë 18.5.2007

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 24 dhe 19 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-------------------------------------|---|
| 1. Ali Isuf Pemelica | 9. Lulëzim Sulejman Sulejmani |
| 2. Kristina Pipo Tili (Stathi) | 10. Alfred Pandeli Marto |
| 3. Zoi Gori Spaho | 11. Vasil Pandeli Marto |
| 4. Qemal Beqir Perizoviq | 12. Jorgo Savo Nikopullo |
| 5. Mukades Avdulla Perizoviq (Mema) | 13. Miranda Xhemil Nikopullo (Xheka) |
| 6. Sllovenko Radomir Xhudoviq | 14. Arjan Luto Saliaj |
| 7. Fifika Polo Naçi | 15. Merita Sulejman Bushkoviç (Sulejmani) |
| 8. Shkurte Veli Ulaj (Genica) | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5324, datë 21.5.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Rezar Bregu, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Argjentinës, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën Federative të Brazilit, në Republikën e Ekuadorit, të Kilit, të Kolumbisë, të Paraguajit, të Perusë, në Republikën Orientale të Uruguajit dhe në Republikën Bolivariene të Venezuelës, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5330, datë 23.5.2007

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Gentiana Salih Karpuzi
2. Ardiana Ali Rexhepi
3. Viedita Jusuf Veliu
4. Linditrim Latif Gashi
5. Getoar Fatmir Rexhepi
6. Herolind Qerim Nishevc
7. Burim Agim Zeqiri
8. Samir Sadik Ujkani
9. Xhafer Zenel Gashi
10. Fahri Xhafer Gashi
11. Kimete Azem Gashi (Xhetova)
12. Arbrije Xhafer Gashi
13. Fetah Januz Kryeziu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

AKT NORMATIV
Nr.1, datë 25.5.2007

PËR LEJIMIN E HYRJES, NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË DISA NJËSIVE TË FORCAVE USHTARAKE TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, NË KUADËR TË OPERACIONIT TË MASAVE TË SIGURISË, PËR VIZITËN E PRESIDENTIT AMERIKAN NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 2, pika 3, 12, pika 3, dhe 101, të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Lejimin e hyrjes, qëndrimit dhe të lëvizjes, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të njësive të forcave ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të mjeteve të tyre ushtarake, për pjesëmarrjen në operacionin e përbashkët për masat e sigurisë, para dhe gjatë vizitës së Presidentit të SHBA-së, në Shqipëri.

Neni 2

Republika e Shqipërisë, në kuadër të operacionit të përbashkët për masat e sigurisë, vë në dispozicion hapësirën tokësore, detare dhe ajrore, përfshirë portet dhe aeroportet, si dhe krijon lehtësitë e nevojshme për kryerjen e këtij misioni.

Neni 3

Njësitë e forcave ushtarake të SHBA-së, të angazhuara në operacionin e përbashkët për masat e sigurisë, lejohen të kryejnë veprimet e përshtatshme ndaj çdo lloj kërcënimi apo rreziku, që mund të cenojë sigurinë e vizitës, duke përdorur, nëse është e nevojshme, edhe forcën, në përputhje me intensitetin e rrezikut apo të kërcënimit.

Marrja e masave të përshtatshme ushtarake dhe reagimi, në raste kërcënimi e rreziku, parashikohen në marrëveshje teknike dypalëshe.

Ministri i Mbrojtjes autorizohet të negociojë dhe të nënshkruajë marrëveshjen teknike, për përmbushjen e këtij misioni.

Neni 4

Statusi i forcave ushtarake të SHBA-së është përcaktuar në “Marrëveshjen plotësuese ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës të “Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre”, për statusin e forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë”, nënshkruar më datë 31.3.2004 dhe ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.9246, datë 24.6.2004.

Neni 5

Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e tjera shtetërore e strukturat në varësi të tyre, të cilave u kërkohet bashkëpunim, në kuadër të operacionit të përbashkët të masave të sigurisë, e ofrojnë menjëherë bashkëpunimin e kërkuar, sipas objektit të veprimtarisë shtetërore, që kryejnë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.289, datë 22.5.2007

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një njësie ushtarake italiane, të përbërë prej 5 (pesë) trupash dhe 3 (tri) mjetesh, në itinerarin Bllacë-Porti i Durrësit-Bllacë, në datat 21-22 maj 2007.

Pika e hyrjes dhe e daljes në/dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë do të jetë pika e kalimit kufitar Bllacë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, në “Marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Gjatë itinerarit të lëvizjes trupat italiane të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.294, datë 16.5.2007

**PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA,
DËRGUAR ME MISIIONE USHTARAKE JASHTË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes e të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2007, të bëjë me INSIG sh.a., sigurimin e jetës dhe të aksidenteve në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që janë me mision ushtarak jashtë shtetit.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe INSIG sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.296, datë 16.5.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I
RRETHRROTULLIMIT DHE UNAZËS LINDORE, FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrethrotullimit dhe unazës lindore, Fier.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 121 m² tokë truall, të vlerësuar me 10 000 lekë/m², me vlerë të përgjithshme 1 210 000 (një milion e dyqind e dhjetë mijë) lekë dhe për objektin me vlerë 2 081 221 (dy milionë e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e një) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 3 291 221 (tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e një) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 179 000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 3 291 221 (tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e një) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.5.2007 dhe të përfundojë më 15.6.2007.

7. Pronarët e përcaktuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Deri në këto çaste paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


**LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I RRETHRROTULLIMIT DHE UNAZËS LINDORE, FIER**

Nr.	Emri	Nr.pas	Sip.m ² truall	Çmimi lekë/m ²	Objekt me vlerë lekë	Vlera lekë	Shënime
1	Agush Aqif Veliu	5/188	67	10 000		670 000	Plotësim dokumentacioni
2	Juljan Dashamir Mahmutaj	7/263	54	10 000	2 081 221	2 621 221	Plotësim dokumentacioni
	Totali					3 291 221	

PLANIMETRIA E NDERTIMIT TE UNAZES FIER NGA PIK.1 - 7

L = 272.4 M

SHK. 1:500



Rruga fillon nga piketa Nr.0 deri ne piketen N7.

te rruges qe do te behet me rrugen ekzistuese Nga piketa nr.0 deri ne piketen 3/a gjersia e rruges do te ruaj ate ekzistuese.

Kurse nga piketa 3/a dhe ne vazhdim do te behet zgjerimi i saj nga te dy krahet duke lene nga nje krah vend parkimi prej 2.5 metra

Gjersia e rruges eshte parashikuar 7.5 metra + 2x0.5 kuneta+2.5 parkim

Nga te dy krahet eshte parashikuar ndertimi i trotuarit

nga 1.5 m deri ne 2 metra


Ne kete segment rruge eshte parashikuar prishja e te gjithes shiresave dhe berja e shtresave te reja sipas prerjeve korespondente.

pikaf fikse per pikturimin e rruges do te jene PUZ te rruges ekzistuese. Dy bordurat ekzistuese dhe shyllat elektrikesi dhe lampat.

I gjithes ki segment do te kete pjerresi te nje anshme sipas ktheses

1:500
CHS

PLANIMETRIJA E NDRYSHIM PROJEKTI PK 28+32
SHK. 1:1000



VENDIM
Nr.297, datë 16.5.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN SI REZULTAT I
REHABILITIMIT TË SHKARJEVE TË NDODHURA NË SEGMENTIN RRUGOR
ZONA IV, PROSEK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i rehabilitimit të shkarjeve të ndodhura në segmentin rrugor zona IV, Prosek.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së paraqitur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 1 546 m², tokë/arë, e vlerësuar me 400 lekë/m² dhe 630 m² tokë/arë, e vlerësuar me 900 lekë/m², në shumën e përgjithshme me 1 185 400 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 179 000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 185 400 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale, për t’u përdorur për shpronësimet.
 6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit qershor 2007.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6.
 8. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I REHABILITIMIT
TË SHKARJEVE TË NDODHURA NË SEGMENTIN RRUGOR ZONA IV, PROSEK**

Pronari	Z.K	Nr.Pas	Sip.arë	Çmimi arë lekë/m ²	Vlera tokës (lekë)	Vlerë totale shpronësimi (lekë)
Aleksandër Ndue Ndrejaj	2915	245/2	1546	400 kateg V	618 400	
Zef Ndue Lleshaj	3242	196/4	630	900 kateg III	567 000	1 185 400

Vlera totale e shpronësimit është 1 185 400 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë.

SH 1:500



OPROJIZIONI I SAKTE PËR PËSETES TË KONTROLLIT DU TË PËRCAKTOHET
NË VEND NGA INXHIENI NË BASHKËPUNIM ME KONTRAKTORIN DUKE U
VENDOSUR NË PËNEN NË TË ULËT
KANALI I DALJES TË TOMORINIS EKZISTUESE DU TË VISHET ME BETON
PËRTEJ MURIT QATËSOR ME GABIONA
SHITRESAT E RRUGES NË PËSENE OË KA CEDIME DUHET TËPËRISHEN DHE
TË RINDËRTOHEN, QATË KETIJ PROCES TË KONTROLLTOJEN ME KUJDES
PËRMBUSHIA E TRUPIT TË RRUGES EDHE NË PËSENE PAK DEMITUAR TË
SHPALTIMIT NË PRAPËT SE KONSTATOJHET QËSË E DOBET DUHET TË PRISHET
DHE KJO PËSE.


Kanal betoni nga dalja e tomb. ekz.
deri ne dalje te murit $L=15m$

Mur me gabionate posacem
H=4.0m L=70.0m

Kanal per shkarkimin e ujrave te drenazhit
me tubbetoni d=20cm L=50m

 Infrastruktura Projekt Ltd. OTVORNOST ZA DOKUMENTACIJU	STUDIUM PROJEKTIMA MASA INXHINIERIKE KODER KAMEZ, MILOT, PLANE, RUBIK -ZONA 4 PROSEK-	FAZA PROJEKT-ZBATIM SH 1-500
Nr Eketes 09	NENZONA 'C' PLANIMETRIA	TETOR 2004

Ing. Grace Young



Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve		Drejtori	R. K. H. U. T. A	Nenahetimi	Drejtori Projekt	Ing. F. K. U. R. L. A	Nenahetimi	Projektues	Ing. F. K. U. R. L. A Ing. O. S. H. A. C. H. I. U. Ing. E. M. A. R. D. D. U. R. M. S. H. I.	Nenahetimi	EG - CO	Masa Inzhinierke Ura e Matit dhe Perlat i Epërm (Projekt Zbatim) PLANIMETRA E MARS PRUV ENT L. 000 Field No
---	--	----------	------------------	------------	------------------	-----------------------	------------	------------	---	------------	---------	---

URDHËR
Nr.4/1, datë 24.5.2007

PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË NJË VEPRIMTARIE FINANCIARE NË LICENCËN E
SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË “CREDINS” SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53 pika 1 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të nenit 1 pika 3 dhe nenit 26 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 9 pika 3 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.100, datë 19.12.2000, të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.83, datë 8.10.2003 “Për miratimin e matricës “Për nivelin e vendimmarrjes së mbikëqyrjes bankare””, të nenit 8 dhe 13 të rregullores nr.96, datë 26.12.2003 “Për licencimin e subjekteve jobanka”, pasi u njoha me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes të datës 23.5.2007

URDHËROJ:

1. Miratimin e shtesës për kryerjen e veprimtarisë së qirasë financiare në licencën nr.4, datë 13.6.2007 të subjektit financiar jobankë “Credins” sh.a.
 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për njoftimin e këtij vendimi subjektit financiar jobankë “Credins” sh.a.
 3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.31, datë 19.5.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR LICENCIM NË
AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA H/C EGNATIA, KOMUNA HOTOLISHT, LIBRAZH, D,
TË “REMI” SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11 germa “A”, si dhe neneve 10 pika 2 dhe 14 pika 2 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullat për procedurat e licencimit”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Remi” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Egnatia, komuna Hotolisht, Librazhd

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të “Remi” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

NDREQJE GABIMI

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.152, datë 7.3.2007, botuar në Fletoren Zyrtare nr.41/2007 në faqen 1091, në pikën 1, bëhet korrigjimi si më poshtë:

janë:

1. Një përfaqësues nga Drejtoria Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë;
2. Dy përfaqësues nga Ministria e Financave;

bëhen:

1. Dy përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
2. Një përfaqësues nga Ministria e Financave;

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 31.5.2007
Doli nga shtypi më 31.5.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Grafon”
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë